

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr.2004/07

Prishtinë, më 28 prill 2004, në orën 10:15

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Hydajet **Hyseni**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 75 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
3. Shqyrtimi i planit për zbatimin e "Standardeve për Kosovën";
4. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës -nr.2003/33;
5. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për energjinë -nr.2004/06;
6. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për rregullatorin e energjisë -nr.2004/07;
7. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për energjinë elektrike -nr.2004/08;
8. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për njësitë matëse -nr.2004/09;
9. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për standardizim -nr.2004/10;
10. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për materialin fidanor -nr.2004/01;
11. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për marrëveshjet financiare ndërkombëtare -nr.2004/11;
12. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për kinematografinë e Kosovës -nr.2003/36;

13. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"-nr. 2004/05;
14. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve – nr.2004/12;
15. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për ndërtimet– nr.2004/13;
16. Shqyrtimi i raportit për gjendjen në minierat e Kosovës;
17. Shqyrtimi i rekomandimit për emërimin e prokurorëve dhe
18. Përgjigjet e ministrave pyetjeve të deputetëve.

Në fillim të seancës, kryetarët e grupeve parlamentare e kërkuan fjalën.

Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së shprehu pakënaqësi me zhvillimet e sotme në disa fshatra të Drenicës dhe me vazhdimin e tendencës së burgosjes së njerëzve jashtë rregullave të shtetit të së drejtës. Ne e gjykojmë arrestimin e zotit Sami Lushtaku dhe mendojmë se po vazhdon një tendencë e burgosjes dhe e inkriminimit të njerëzve më të merituar të këtij vendi dhe kërkojmë që këto praktika të ndërpriten.

Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoj që nga shqyrtimi i sotëm, të shtyhen për seancë tjetër pikat e propozuara të rendit të ditës: 11,12 dhe 13, ngase nuk janë bërë përgatitjet e nevojshme për shqyrtimin e tyre.

Bujar Dugolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se nuk e përkrah propozimin për heqjen nga rendi i ditës shqyrtimin e projektligjeve, të propozuara nga Kryesia, ngase nuk ka arsye bindëse pse ato të hiqen.

Tomë Hajdaraj, në emër të Komisionit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, tha se kanë disa vërejtje në P/ligjin për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", të cilat duhen të inkorporohen në këtë p/ligj. Ai propozoi që ky p/ligj t'i kthehet sponsoruesit për riformulim.

Arsim Bajrami tha se nuk e përkrah propozimin për heqjen e p/ligjeve nga rendi i ditës. Vërejtjet mund të inkorporohen në tekstin e p/ligjit gjatë shqyrtimit, përmes amendamenteve.

Pas kërkesës për heqjen nga rendi i ditës dhe kundërshtimit të saj, Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që shqyrtimi i dytë i P/ligjit për marrëveshjet financiare ndërkombëtare, i P/ligjit për kinematografinë e Kosovës dhe i P/ligjit për parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", të shtyhen për seancën e ardhshme plenare.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.